



**Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosova**

**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**

**Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry**

**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë publikon broshurën për Ligjin  
Nr. 05/L-110 për Kamatë-vonesat në Transaksionet Tregtare**

Në vazhden e aktiviteteve të shumta Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka përgatitur edhe publikimin e kësaj broshure të veçantë, që ka për qëllim krijimin e një fushate, për promovimin dhe rritjen e vetëdijesimit të bizneseve lidhur me mjetet juridike për kamatë-vonesën në mes të shoqërive tregtare dhe autoriteteve publike. Për më tepër, MTI synon që përmes kësaj forme të informoj të gjitha bizneset kosovare lidhur me obligimet dhe përfitimet e mundshme që do të sjell Ligji për Kamatë-Vonesat në Transaksionet Tregtare.

Ligji ka për qëllim parandalimin e vonesave të pagesave në transaksionet tregtare si dhe përcaktimin e rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatë-vonesave. Për më tepër, do të rregullojë të gjitha transaksionet tregtare midis kontraktuesit kryesorë dhe furnizuesit të tyre dhe nën-kontraktorët.

**Zbatohet për të gjitha pagesat e kryera, në kompensim për punët juridike tregtare**

“Transaksion tregtar” nënkupton transaksionet në mes ndërmarrjeve ose ndërmjet ndërmarrjeve dhe autoriteteve publike, të cilat çojnë në shpërndarjen e mallrave ose kryerjen e shërbimeve kundrejt një pagese.

“Pagesë e vonuar” do të thotë pagesa nuk është bërë brenda periudhës kontraktuale ose ligjore të pagesës dhe ku kushtet e parashtruara në nenin 4 dhe 5 janë përmbushur.

Kamata referente si pjesë e kamatë-vonesës ligjore do të publikohet nga Banka Qendrore e Kosovës, çdo gjashtë muaj me datën 1 shkurt dhe 1 gusht të vitit kalendarik. Kamata referente publikohet në web-faqen e BQK-së <http://www.bqk-kos.org>.

Gjithsesi, ligji do të sigurojë që në transaksionet tregtare ndërmjet sipërmarrjeve, kreditori të ketë të drejtë të interesit për pagesë të vonuar, pa nevojën e rikujtimit, atëherë kur kushtet si në vijim janë të përmbushura:

• Kreditori ka përmbushur detyrimet kontraktuese dhe ligjore të tij

• Kreditori nuk e ka marrë shumën e mbetur me kohë, përveç nëse debitori nuk është përgjegjës për vonesë

“Interesi për pagesë të vonuar” do të thotë interes ligjor për pagesë të vonuar ose interes në një normë të rënë dakord ndërmjet ndërmarrjeve, siç është paraparë me këtë ligj

“Kamata referente e interesit” - norma ekuivalente e vendosur nga Banka Qendrore, do të publikohet çdo gjashtë muaj

Kamatë-vonesa ligjore e aplikueshme në transaksionet tregtare është kamata referente e cila vlen për gjashtë muajt e ardhshëm, duke i shtuar kamatën prej së paku 8 pikë të përqindjes.

Në transaksionet midis shoqërive tregtare, kreditori ka të drejtë në kamatë-vonesë duke filluar nga dita e përfundimit të datës së paraparë për pagesë apo përfundimit të afatit që është përcaktuar në kontratë; kur data apo afati për pagesë nuk është përcaktuar në kontratë, kreditori ka të drejtë në kamatë-vonesë: tridhjetë (30) ditë kalendarike pas datës së pranimit të faturës apo një kërkesë të barasvlershme për pagesë nga ana e debitorit; kur data e pranimit të faturës apo kërkesës së barasvlershme për pagesë është e papërcaktuar, tridhjetë (30) ditë kalendarike pas datës së pranimit të mallrave apo shërbimeve; kur debitori e merr faturën apo kërkesën e barasvlershme për pagesë para pranimit të mallrave dhe shërbimeve, tridhjetë (30) ditë kalendarike pas datës së pranimit të mallrave apo shërbimeve; kur procedura e pranimit apo verifikimit me të cilën vërtetohet përshtatshmëria e mallrave dhe shërbimeve është e përcaktuar me kontratë është e parashikuar me ligj ose në

kontratë, si dhe nëse debitori merr faturën ose kërkesë të barasvlershme për pagesë më parë ose në datën në të cilën ai pranim ose verifikim i tillë ndodh, duhet të realizohet pagesa brenda tridhjetë (30) ditë kalendarike pas asaj date. Palët kontraktuese do të garantojnë që afati për pagesë që përcaktohet në kontratë nuk i tejkalon gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike, përveç nëse në kontratë janë pajtuar ndryshe shprehimisht dhe me kusht që kjo të mos jetë e padrejtë ndaj kreditorit sipas nenit 8 të këtij ligji. Shitësi e ruan të drejtën e pronësisë mbi mallrat derisa ato të paguhet në tërësi, nëse blerësi dhe shitësi janë pajtuar shprehimisht me klauzolën për ruajtjen e drejtës të pronësisë para dorëzimit të mallrave. Dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve që rregullojnë kamatë-vonesën mbeten të zbatueshme për kontratat që janë lidhur, dhe faturat që janë lëshuar para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

*Kamatë-vonesa ligjore aplikohet edhe për transaksionet me sektorin privat, ashtu sikurse në transaksionet e sektorit publik.*

*Sa i përket transparencës dhe vetëdijesimit, MTI do të kujdeset që të ketë transparencë përkitazi me të drejtat dhe detyrimet që dalin nga ky ligj ndërsa, BQK do të vë në dispozicion të publikut kamatën referente çdo gjashtë muaj siç është paraparë me këtë ligj.*